

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BESA ALB REAL ESTATE” SHPK

Sot, më datë **28 Mars 2025** (dymijë e njezete e pese), ortaku themelues:

- **FONDACIONI “Albanian Besa Capital”** regjistruar në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 287, datë 19.09.2008 dhe numër identifikimi NIPT K92431451E, me seli: Rruga “Dritan Hoxha”, Ndertesa 109, Tiranë, përfaqësuar me vendim të Bordit Drejtues të Fondacionit date 26/03/2025 nga Zj. Luljeta ÇENO – Drejtore e Departamentit të Finances të Fondacionit ABC, shtetase shqiptare, e bija e Lilit dhe Sena, e datëlindjes 13/12/1979, lindur në Divjake dhe banuese në Tirane, në adresën: Rr. “Nikolla Tupe”, Nd. 11, Ap.3, Tirane, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e leternjoftimit me nr. personal H96213095H,

Ka vendosur themelimin e shoqërisë tregtare **“BESA ALB REAL ESTATE” Sh.p.k.** me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare **“BESA ALB REAL ESTATE” Sh.p.k.**, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), (këtu e më poshtë Shoqëria).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **“BESA ALB REAL ESTATE” Sh.p.k.** Ajo do të ketë vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtem:

1. Agjensi imobiliare krijim, zhvillim, aktivitet ndermjetesimi per pasurite e paluajtshme, zyre ndermjetesimi per pasurite e paluajtshme nepermjet nenshkrimit te nje kontrate te vecante Franchising.



2. Aktivitetet në fushën e pasurive të paluajtshme, vlerësimin e pasurive të paluajtshme, angazhimin në shitjen me shumicë dhe pakicë të çdo lloji pasurie dhe të hapësirave, dege apo zyra po të jetë e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë.
3. Menaxhim dhe administrim pronash dhe objekteve. Administrimin e bashkepronësisë në pronë dhe ndërtesa për dënim me qira, nën qira të ambienteve të ndryshme.
4. Ndermjetësim në lidhje me shitjen e produkteve të ndryshme.
5. Pjesëmarrje në investime në fushën e ndërtimit dhe tregtimit, brenda dhe jashtë vendit të pasurive të paluajtshme.
6. Transportim mallrash, shërbime të ndryshme të lidhura me këto aktivitete.
7. Kryerjen e çdo aktiviteti tjetër të nevojshëm në funksion të veprimtarisë së saj.

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj duke u bazuar tek lejet, licencat, aprovimet apo autorizimet e tjera të ligjshme të lëshuara nga institucionet qeveritare kompetente të fushës.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën, Rruga Elbasanit, Njesia Bashkiake Nr. 2, Pallati EDIL-AL- IT, Nr. 45, Pranë Ambasades Amerikane, Nr. Pasurie 4/225, Zona Kadastrale nr. 8160, Tiranë, Shqipëri.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie në Lekë.

Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej **30,000,000 (tridhjetë milionë) Leke**. Ortaku themelues i Shoqërisë tregtare **“BESA ALB REAL ESTATE” Sh.p.k.**, zotëron 1 kuotë në vlerën 100 % të saj.

Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortaku themelues. Pjesa e kapitalit themeltar do të kryhet sapo të hapen llogaritë bankare të shoqërisë tërësisht në të holla nga ortaku i shoqërisë.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të pacaktuar.

Neni 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - organi më i lartë vendim-marrës;
2. Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.



Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat jo me te gjate se 5 (pesë) vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administator i pare i shoqërisë do të jetë **Zj. Erta Resnja**, shtetase shqiptare, e bija e Astritit dhe Raimonda, e datelindjes 22.01.1993 lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane, person madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtëse e dokumentit me nr. Personal J35122044L, me afat emerimi **5 (pese) vjet** me te drejte rizgjedhje.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët Kontabël

Eksperti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

NENI 9

Pjesëmarrja në shoqëri të tjera

Ortaku themelues mund të vendose me vullnetin e tij për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe ngritja e filialeve

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutin.

NENI 11

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduqin Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaku themelues dhe i vulosur përpara noterit, në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.



NENI 13

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarreveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakut dhe shoqërisë zgjidhen nga ortakut themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 14

Dispozita Përfundimtare

Akti i themelimit përpilohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKU THEMELUES

FONDACIONI ALBANIAN BESA CAPITAL

- perfaqesuar me Vendim Bordi Drejtues te Fondacionit ABC, nga:

Luljeta ÇENO

Luljeta Ceno



VENDIM
I
BORDIT DREJTUES TË FONDACIONIT
ALBANIAN BESA CAPITAL

Sot, më datë **26/03/2025**, në selinë e Fondacionit Albanian Besa Capital, në Tiranë, u mbledh Bordi Drejtues për të diskutuar dhe vendosur në lidhje me rendin e ditës të njoftuar rregullisht si më poshtë:

1. Pjesëmarrjen si ortak i vetëm në masën 100% në investim në krijimin dhe regjistrimin e shoqërisë tregtare me emërtimin **“BESA ALB REAL ESTATE” sh.p.k.**
2. Autorizimi i **Zj. Luljeta ÇENO** - Drejtore e Departamentit të Financës të Fondacionit ABC - për të vepruar dhe firmosur si përfaqësues i Fondacionit Albanian Besa Capital çdo akt të nevojshëm lidhur me themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit.
3. Të ndryshme.

Në mbledhje janë të pranishëm anëtarët e Bordit Drejtues të Fondacionit:

- | | | |
|---------|---------|-------|
| 1. Z. | Altin | MUÇA |
| 2. Znj. | Irma | DISHA |
| 3. Znj. | Valbona | XHAFA |
| 4. Znj. | Arjola | STAFI |
| 5. Znj. | Valbona | GREVA |

Në mbledhje merr pjesë edhe Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit ABC, Prof. Asoc. Dr. Bajram MUÇAJ. Te pranishmit janë dakort me rendin e ditës së mbledhjes. Mbledhja procedoi me pikat e rendit të ditës.

Në përputhje me Statutin e Fondacionit ABC, Mbledhja e Bordit Drejtues, pasi ka marrë aprovimin paraprak nga Themeluesit e Fondacionit,

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen si ortak i vetëm në investim në krijimin dhe regjistrimin e shoqërisë tregtare me emërtimin **“BESA ALB REAL ESTATE” sh.p.k.**
2. Pjesëmarrja e Fondacionit ABC në kapitalin e shoqërisë do të jetë në masën **100%** të kapitalit. Kontributi në para i Fondacionit ABC në proporcion me përqindjen e pjesëmarrjes do të jetë në shumën **30,000,000 Leke** (Tridhjetë milionë Leke).
3. Me krijimin e shoqërisë dhe regjistrimin e saj pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit dhe hapjen e llogarive bankare të shoqërisë, të kryhet pagesa e kontributit në para në vlerën e mesipërme.
4. Autorizohet **Zj. Luljeta ÇENO** – Drejtore e Departamentit të Financës të Fondacionit ABC për të vepruar dhe firmosur si përfaqësues i Fondacionit Albanian Besa Capital, çdo akt të nevojshëm lidhur me themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANETARET E BORDIT DREJTUES

Prof. Asoc. Dr. Altin MUÇA

Kryetar

Altin Muça

**FONDACIONI
A.B.C.**

ALBANIAN BESA CAPITAL

Irma

DISHA

Irma Dishaj

Anëtare

[Signature]

Arjola

STAJA

Arjola Stajaj

Anëtare

[Signature]

Valbona

XHAEJA

Valbona Xhaja

Anëtare

[Signature]

Valbona

GREVA

Valbona Greva

Anëtare

[Signature]

VENDIM
I
MBLEDHJES SE THEMELUESVE

Sot me date 26/03/2025, Themeluesit e Fondacionit Albanian Besa Capital pasi u njohen me materialin e paraqitur nga Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit ne lidhje me pjesemarrjen si ortak i vetem ne masen 100% ne investim, ne krijimin dhe regjistrimin e shoqerise tregtare me emertimin **“BESA ALB REAL ESTATE” sh.p.k** dhe pasi konstatuan qe:

- Per permbushjen e qellimit te krijimit te Fondacionit ABC, bazuar ne Statutin e tij, neni 3, objekt i veprimtarise se Fondacionit eshte edhe “Pjesëmarrja në Institutet Financiare dhe në Shoqëri Tregtare me objekt veprimtarie të ndryshme si dhe të çdo lloji dhe forme organizimi”;
- Në statutin e Fondacionit ABC, neni 18, pika 4 është përcaktuar që: “Ndryshimet në gjendjen e pasurive të Fondacionit, (shitje apo blerje asetesh, aksionesh, etj.) bëhen me vendim të Bordit Drejtues pasi është marrë aprovimi i themeluesit”.

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 3 dhe 18 të Statutit të Fondacionit, Themeluesit,

VENDOSEN:

1. Pjesemarrjen si ortak i vetem ne investim, ne krijimin dhe regjistrimin e shoqerise tregtare me emertimin **“BESA ALB REAL ESTATE” sh.p.k.**
2. Pjesemarrja e Fondacionit ABC ne kapitalin e shoqerise do te jete ne masen **100%** te kapitalit. Kontributi ne para i Fondacionit ABC ne proporcion me perqindjen e pjesemarrjes do te jete ne shumen **30,000,000 Leke** (Tridhjetë milione Leke).
1. Autorizohet Bordi Drejtues i Fondacionit për marrjen e vendimeve dhe kryerjen e të gjitha veprimeve ligjore të nevojshme për realizimin e investimit te mesiperm dhe kryerjen e pageses se kontributit ne para per pjesemarrjen ne kapitalin themelues te shoqerise.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

THEMELUESIT:

Irma DISHA



Valbona XHAFA



Bajram MUÇAJ



Altin MUÇA



Vangjel SHAKAJ

